



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 89, Datë 20.04.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË
“SONNE” SH.P.K., PËR LICENCIMIN NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK TOPOJË ME FUQI TË
INSTALUAR 1998 KW**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”; neni 5, pika 1 gërma “a”; neni 10, pika 3 dhe 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 109, datë 29.06.2016; neneve 15 dhe 19 pika 1 gërma “a” e “Rregullave për Organizimin, Funkionimin dhe Procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016”; bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.04.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “SONNE” sh.p.k, në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 KW,

Konstatoi se:

- Me shkresën me nr. 3 Prot, datë 01.02.2018, protokolluar në ERE me nr.149 Prot, datë 02.02.2018, shoqëria “SONNE” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë për t’u pajisur me licencë në aktivitetin e Prodhimit të Energjisë Elektrike nga centrali fotovoltaik Topojë me kapacitet të instaluar 1998 KW.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 53, datë 07.03.2018, vendosi mosfillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SONNE” sh.p.k, për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik Topojë me kapacitet prodhues 1998 KW, për shkak të mangësive në dokumentacionin e depozituar
- Me shkresën me nr. 6 Prot., datë 30.03.2018, dhe protokolluar në ERE me nr. 149/3 Prot., datë 03.04.2018, shoqëria “SONNE“ sh.p.k., ka ri-aplikuar në ERE për t’u pajisur me

licencë në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Centrali Fotovoltaik Topojë, me kapacitet të instaluar 1998 KW.

- Në nenin 10, pika 7 të *“Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”* parashikohet se : *“Nëse aplikuesi paraqet aplikimin e ri në përputhje me pikën 6 të këtij neni brenda 1 muaji nga marrja e vendimi për mosfillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm do të konsiderohet i vlefshëm për aplikimin e ri.”*
- Sa më sipër, rezulton se aplikimi i shoqërisë është paraqitur brenda afateve të parashikuara në dispozitat më sipër.
- Shoqëria “SONNE” sh.p.k ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën me nr. 2278 Rep dhe nr. 1052/3 Kol., datë 12.10.2017, për "Ndërtimin, shfrytëzimin dhe Administrimin e Centralit Fotovoltaik Topojë" me kapacitet prodhues 1998 KW, në Bashkinë Fier, Qarku Fier, bazuar në nenin 25 të VKM nr. 822, datë 07.10.2015. Në nenin 3 të kontratës janë përcaktuar koordinatat për ndërtimin e Centralit Fotovoltaik Topojë, që do të ndërtohet në perëndim të Topojës, pranë plazhit të Semanit, në qarkun e Fierit. Centrali Fotovoltaik do përbëhet nga 8400 celula (njësi prodhimi), me një fuqi të instaluar 1998 KW. Ky Park Fotovoltaik, parashikohet të prodhojë rreth 3 GWh në vit. Për transmetimin e energjisë së prodhuar nga Centrali Fotovoltaik Topojë do të ndërtohet një linjë ajrore 35 kV rreth 2,7 km e gjatë, e cila do të lidhet në N/st 35/10 kv të Hoxhares. Pika e matjes së energjisë që Centrali Fotovoltaik Topojë do të injektojë në rrjet, do të jetë në kufijtë e pronësisë ku dorëzohet energjia, gjë e cila do të përcaktohet me lidhjen e marrëveshjes me blerësin e energjisë.

Aplikimi i shoqërisë “SONNE” sh.p.k, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në *“Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”*:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”) janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pikat 4.4.1 4.4.2, 4.4.3, 4.4.4 dhe 4.4.5 gërma “a”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Nenin 9 pika 4.4.5 gërma “b” (leje mjedisore nga organet përkatëse); do të njoftohet subjekti që t’i plotësojë ato brenda afateve që përcakton “Rregullorja për Procedurat dhe Afatet për Dhënien, Modifikimin, Transferimin, Rinovimin ose Heqjen e Licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike.”

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “SONNE” sh.p.k., për licencimin në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik Topojë me fuqi të instaluar 1998 KW.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI